

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



**LËNDA: BASKETBOLL**

Tema Relacionet e disa karakteristikave morfologjike dhe ndryshoreve  
lëvizore bazike e specifike tek nxënësit e moshës  
13-14 vjeç në Basketboll

**Mentori:**  
**Prof.Dr. Hazir Salihu**

**Kandidati:**  
**Vilson Hajdari**

**Prishtinë – 2021**

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"

FACULTY OF PHYSICAL EDUCATION AND SPORTS



**SUBJECT: BASKETBALL**

Topic: Relationships of some morphological characteristics and basic  
and specific motor variables in students of aged  
13-14 in Basketball

**Mentors:**  
**Prof. Dr.Hazir Salihu**

**Candidates:**  
**Vilson Hajdari**

**Prishtina - 2021**

## Përmbajtja

1. HYRJE .....	6
2. QËLLIMI I HULUMTIMIT .....	7
2.1. Hipotezat e hulumtimit .....	7
3. Pasqyra e disa hulumtimeve të deritanishme .....	8
4. METODOLOGJIA E PUNËS SË PUNIMIT .....	11
4.1. Metodatat e perpunimit te rezultatetve .....	11
4.2. Mostra e entiteve .....	11
4.2.1. Instrumentet matëse morfologjike .....	12
4.2.2. Përshkrimi i i ndryshoreve morfologjike .....	13
4.2.3. Përshkrimi i ndryshoreve të motorikes bazike .....	17
4.2.4. Përshkrimi i ndryshoreve të motorikës situacionale .....	21
4. Mënyra e zbatimit të punimit .....	24
6. REZULTATET DHE INTERPRETIMI .....	25
6.1. Treguesit themelor statistikorë në hapësirën antropometrike dhe motorike në matjet e nxënësve të moshës 13 vjeçare .....	25
6.2. KORELACIONET E NDRYSHOREVE MOTORIKE MANIFESTE TË NXËNËSVE TË MOSHËS 13 –vjeçare .....	27
6.2.1 Korelacionet e ndryshoreve në hapësirën antropometrike manifeste të nxënësve .....	27
6.2.2. Korelacionet e ndryshoreve në hapësirën e motorikës bazike dhe motorikës specifike manifeste të nxënësve .....	28

6.3. KROSKORELACIONET E NDRYSHOREVE MANIFESTE .....	29
6.3.1 Kroskorelacionet ndërmjet ndryshoreve në hapësirën antropometrike .manifeste të të nxënësve.....	29
6.4. FAKTORIZIMI I HAPËSIRËS MANIFESTE .....	30
6.4.1. Faktorizimi i hapësirës antropometrike të nxënësve 13 vjeçarë.....	30
6.4.2 Faktorizimi i hapësirës motorike të nxënësve 13 vjeçarë .....	31
6.5 Treguesit themelorë statistikorë të nxënësve 14 vjeçarë.....	34
6.5.1 Treguesit themelor statistikorë në hapësirën antropometrike dhe motorike në matjet e nxënësve të moshës 14 vjeçare .....	36
6.5.2 KORELACIONET E NDRYSHOREVE MOTORIKE MANIFESTE TË NXËNËSVE TË MOSHËS 14 –vjeçare.....	36
6.5.2.1. Korelacionet e ndryshoreve në hapësirën antropometrike manifeste të nxënësve .....	36
6.5.2.2. Korelacionet e ndryshoreve në hapësirën e motorikës bazike dhe specifike manifeste të nxënësve.....	37
6.5.3. KROSKORELACIONET E NDRYSHOREVE MANIFESTE .....	38
6.5.3.1 Kroskorelacionet ndërmjet ndryshoreve në hapësirën antropometrike manifeste të të nxënësve.....	38
6.6. FAKTORIZIMI I HAPËSIRËS MANIFESTE .....	39
6.6.1. Faktorizimi i hapësirës antropometrike të nxënësve 14 vjeçarë.....	39
6.6.2. Faktorizimi i hapësirës motorike të nxënësve 14 vjeçarë .....	40

7. ANALIZA DHE VERIFIKIMI I HIPOTEZAVE.....	41
8.PËRFUNDIMI .....	42
9. ABSTRAKTI .....	44
10.BIBLIOGRAFIA.....	46
11. Diagramet antropometrike dhe motorike.....	50
11.1. Diagramet e nxënësve 13 vjeç .....	50
11.2. Diagramet e nxënësve 14 vjeç.....	55

## 1.

## HYRJJE

Basketbolli si një lojë tejet atraktive ka zgjuar kërshërinë e miliona të rinjve e të rejave të cilët shfrytëzojnë rastin që në mes dy koshave të argëtohen, relaksohen, shoqërohen etj. Popullarizimi i kësaj loje dita-ditës po shtohet e sidomos tek ne ka përfituar zemrat e shumë të rinjve që kopetetet duhet të kujdesen për t'i krijuar kushte dhe hapësirë sepse janë ardhmëria e jonë.

Të përcaktuarit – analiza e njohjes dhe hulumtimit të kësaj problematike, në një popullatë autoktone janë përcaktuar edhe vetë autorët e këtij eksperimenti. Ndërkaq, në saje të kompleksitetit të problematikës, hulumtimet shkencore edhe më tej do të jenë çështje e zërthimit në praktikën tonë kineziologjike. Njohja e statusit psikosomatik të njeriut është përpjekje për zgjidhjen dhe zbatimin e operatorëve kineziologjikë.

Mund të konstatojmë se rezultatet e këtij hulumtimi me një grup të mjaftueshëm të rinj të gjinisë mashkullore do të ketë rëndësi të veçantë jo vetëm për këta të rinj por njëherit edhe porosi për kuadrin profesional, që me një qasje të mirëfillt të njohjes dhe studimit të kësaj problematike, do të mund të avancohen vlerat e Edukimit Fizik e në veçanti lojës së basketbollit dhe vendin më meritore të cilit edhe i takon.

Në këtë projekt studimi- eksperimentimi, shtrohet detyrë prioritare e definimit të strukturës dhe relacioneve të nënsistemeve siç janë: dimensionet morfologjike, lëvizore bazike dhe specifike, kognitive, konative etj, të cilat gjatë aktiviteteve të ndryshme lëvizore, në kuadër të procesit edukativo-arsimor, iu nënshtrohen proceseve të cilat janë në ndryshim e sipër.

## 2. QËLLIMI I PUNIMIT

Duke u bazuar në dimensionet latente lëvizore dhe morfologjike, si qëllim primar i hulumtimit është konstatimi i disa karakteristikave relevante morfologjike dhe lëvizore bazike dhe specifike, si dhe lidhmërit ndërmjet tyre tek nxënësit e rinj të moshës 13 – 14 vjeç.

### **Qëllimi i hulumtimit do të përkufizohet në:**

Vërtetimin e strukturës së dimensioneve morfologjike dhe lëvizore të përgjithshme dhe situacionale në hapësirën morfologjike manifeste dhe latente.

Vërtetimin e relacioneve ndërmjet karakteristikave morfologjike dhe lëvizore-specifike në hapësirën manifeste dhe latente .

Vërtetimin e ligjshmërive korelative në mes të karakteristikave trupore morfologjike dhe lëvizore bazike e specifike.

Duke u bazuar në rezultate të disa hulumtimeve të deritashme, e në bazë të numrit të instrumenteve matëse i kemi parashtruar disa hipoteza themelore.

### **2.1. HIPOTEZAT THEMELORE:**

- H1.** Supozojmë se ekzistojnë korelacione ndërmjet karakteristikave morfologjike, lëvizore bazike e specifike.
- H2.** Supozojmë se do të ekstrahohen faktorë me rëndësi në hapësirën morfologjike.
- H3.** Supozojmë se do të fitohet strukturë dhe faktor relevant lëvizor bazik dhe Situacional.

### 3.PASQYRA E DISA HULUMTIMEVE TË DERITANISHME

Eksperimentimet-hulumtimet kineziologjike mund të trajtohen si detyrë interesante kërkimore, e disa karakteristikave morfologjike dhe lëvizore të përgjithshme dhe situacionale, si në hapësirën manifeste ashtu edhe në atë latente, duke u bazuar në arritjen e rezultateve të disiplinave sportive, njëherit jemi përcaktuar në ato hulumtime të profileve të ndryshme nga autorët tanë autokton dhe të jashtëm e sidomos që kanë të bëjnë kryesisht me lëminë e basketbollit.

**Z.Johan.:** Në vitin 1991, ka bërë hulumtimin me mostër prej 124 entitete, të ndarë në grupe të caktuara, duke preferuar ndonjë sport e në mesin e tyre edhe basketbollin.

Autori ka trajtuar 11 variabla antropometrike dhe 11 variabla motorike, gjatë përpunimit të rezultateve është aplikuar analiza kanonike-diskriminative .

Grupi diskriminativ më i mirë ishte me testin kërcim së gjati nga vendi, dhe kërcimi trehapësh nga vendi. Këta dy faktorë diskriminativ, janë sinjifikant .

Faktori i parë është i determinuar sipas matjeve antropometrike, ndërsa i dyti sipas testeve motorike. Sipas këtyre rezultateve të cilët janë fituar, erdhi në konkludim se këto rezultate janë në përputhshmëri me hipotezën e parashtruar, mirëpo kërkojnë hulumtim të mëtejshëm, e sidomos në mostrën e paraparë të basketbollistëve të zgjedhur, që të verifikohet ekstrahimi i dimensioneve latente motorike-situacionale.

**M.Nixha.:** Në vitin 1985 në disert. e doc. me temën “Analiza e karakteristikave trupore dhe aftësive motorike të basketbollistëve të niveleve të ndryshme garuese, dhe analiza komparative me hendbollistë dhe volejbollistë”.

Si mostër ka marrë lojtarët e tri ekipeve të para të të tri ranjeve, kurse mostra e variablave ka qenë 11 variabla antropometrike dhe 7 variabla motorike. Pas këtyre analizave ka ardhë në përfundim, se lojtarët e tre sporteve nuk dallohen shumë në mes veti në karakteristikat trupore.



Aty ku ka patur dallime, ato kanë qenë të pritura p.sh. Basketbollistët kanë qenë më të gjatë, hendbollistët kanë patur vlera më të larta në peshë dhe në perimetra, ndërsa volejbollistët indin dhjamorë.

Në karakteristikat e statusit motorik, basketbollistët kanë patur vlera më të larta në agjilitet, hendbollistët në forcë dinamike, dhe volejbollistët në forcë eksplozive ( kërcimi abalak ).

**S.Tancing dhe B.Dezhman.:** më 1989 ka bërë hulumtime me qëllim të vërtetimit të disa ndryshimeve te basketbollistët e rinj, të cilët luajnë nëpër vende të ndryshme.

Mostra e entiteteve ka përfshirë 102 basketbollist të moshës mesatare 15,5vjeç, dhe i ka ndarë sipas roleve që luajnë në lojë.

Mostra ishte përbër prej 25 testeve, kurse rezultatet e hulumtimit i kanë bërë përmes statistikës deskriptive dhe analizës kanonike.

Ndërkaq, sipas të dhënave autorët kanë konstatuar se lojtarët fundor (bekat 1 dhe 2), në basketboll posedojnë rezultate më të mira në krahasim me rolin e qendrave. Kjo tregon se struktura e modelit bek-qendër është e kundërt, deri sa lojtarët anësor gjenden ndërmjet vërtetimit të të dhënave të matjeve.

**H. Salihu.:** Në temën e magjistraturës “ Relacionet e disa karakteristikave morfologjike dhe aftësive lëvizore të përgjithshme dhe situacionale tek basketbollistët e rinj “. Modeli (mostra) prej 108 basketbollistëve të rinj ka vërtetuar strukturë dhe relacione të rëndësishme ndërmjet sistemit të ndryshoreve morfologjike dhe aftësive lëvizore bazike e situacionale ka përfshirë 21 ndryshore prej të cilave ka përfituar 5 faktor me rëndësi si vijon; dy faktorë nga hapësira morfologjike ndërsa tre faktor nga hapësira lëvizore bazike dhe situacionale. E rëndësisë së veçantë në këtë punim vlenë të ceket sepse autori ka bërë krahasimin e rezultateve në testin gjatësia e trupit të mostrës identike me një punim nga Bosnja Hercegovina, dhe si rezultat tregon se të rinjt nga Kosova konkretisht nga kryeqyteti Prishtina janë me rezultat më të mirë për 4cm. Punim Magj. 2000. Prishtinë.

**H. Rushiti :** Struktura faktoriale e dimensioneve morfologjike dhe relacioni i tyre me disa aftësi lëvizore tek të rinjte e moshës 13-14 vjeç.

Mostra e përbërë prej 205 nxënësve ka vërtetuar strukturën dhe relacionet e rëndësishme ndërmjet sistemit të variablave morfologjike (18) dhe atyre lëvizore (12) të fituar dy faktorë morfologjike dhe tre faktorë lëvizore. Punim i magjistraturës në Prishtinë – 1999.

**V. Ameti :** Vlerësimi i disa aftësive lëvizore bazike dhe situacionale tipike për sportin e mundjes – stili i lirë.

Mostra për hulumtim ka përfshirë 105 entitete të moshës 14-15 vjeç të testuar nga 16 teste të hapësirës lëvizore.

Ka vërtetuar ndikimin e variablave lëvizore predikte në prognozimin e rezultateve të ndryshoreve kritere si dhe vërtetimi i lidhmërive ndërmjet ndryshoreve lëvizore, ka fituar tre faktorë. Punim i magjistraturës 2004 – Prishtinë.

**M. Aliu :** Zhvillimi morfologjik dhe disa karakteristika motorike të popullatës dhe diferenca kronologjike të moshës së caktuar. Në mostrën e entiteteve prej moshës 15-17 vjeç me anë të 18 variablave ka trajtuar statusin antropometrik me ç’rast ka ekstrahuar tre dimensione latente: dimensionin e parë është identifikuar si “dimensioni qarkor i skeletit”, i dyti “faktori i indit dhjamor nënlekuror”, i treti “dimensioni transversal i skeletit”.

Disertacion i Doktoraturës Sarajevë – 1992.

**Çitaku. F.**(1985), në hulumtimin “Struktura latente e precizitetit” ka bërë hulumtime me nxënësit e shkollave të mesme të moshës 18 vjeçare në komunën e Lipjanit, të Pejës dhe të Podujevës. Për këtë hulumtim ka pasur gjithsej 32 variabla të precizitetit motorik, ndërsa numri i entiteteve ishte 496 nxënës. Qëllimi themelor i këtij hulumtimi ka qenë konstatimi i strukturës primare të precizitetit latent. Në këtë hulumtim është punuar me analizën faktoriale latente të strukturës së precizitetit, me ç’rast janë vërtetuar tre nivele të strukturës latente të precizitetit.

## **4. METODOLOGJIA E PUNËS SË PUNIMIT**

### **4.1. Metodatat e përpunimit të rezultateve**

Metoda e përpunimit të rezultateve do të realizohet në kuadër të programit statistikorë i inkorporuar në programin më të ri. Definimi i strukturës në hapësirën manifeste dhe latente të dimensioneve morfologjike dhe lëvizore specifike, do të aplikohet:

Analiza faktoriale, lidhmëritë ndërmjet testeve morfologjike dhe lëvizore bazike e specifike, ndërsa në kuadër të analizës do të aplikohet vërtetimi i korelacioneve, kros-korelacioneve ndërmjet variablave morfologjike dhe atyre lëvizore bazike e specifike . Do të llogariten parametrat themelorë statistikorë si në hapësirën morfologjike ashtu edhe në hapësirën lëvizore bazike dhe specifike, mesatarja aritmetike, rezultati minimal dhe maksimal si dhe masat e asimetrisë Skeënes dhe kurtosis.

### **4.2. MOSTRA – E ENTITETEVE**

Modeli-mostra e këtij studim përfshijë numrin prej 60 entiteteve të gjinisë mashkullore të moshës 13-14 vjeç. të cilët kanë ndjekin me rregull procesin mësimorë në orëte edukimit fizik dhe sportit .

Të gjithë nxënësit janë të seleksionuar sa i përket aftësive psiko-fizike, për trajtimin e këtyre testeve të parapara në këtë eksperiment .

Ndryshoret nga morfologjia do te realizohen në orët e paradites, ndërsa testet lëvizore bazike specifike do te realizohen gjatë orëve stërvitore në palestra sportive.

### **4.2.1. Instrumentet matëse morfologjike**

Zgjedhja e instrumenteve matëse është bërë në bazë të disa hulumtimeve të deritashme, në përputhje me realizimin e detyrave të parapara në këtë projekt-hulumtimi. Ndryshoret morfologjike janë marrë nga programi ndërkombëtarë biologjik, dhe hipotetikusht mbulojnë hapësirën morfologjike. Nga morfologjia do të trajtohen 4 ndryshore-teste.

**Në hapësirën lëvizore do të trajtohen 4 (katër) teste; 4 (katër) teste janë bazike, kurse 3 (tri) teste tjera janë situacionale.**

#### **Ndryshoret morfologjike**

ALART Lartësia e trupit

APSHTR Pesha e trupit

AGJAKR Gjatësia e krahut

AGJAKB Gjatesia e këmbës

#### **Ndryshoret lëvizore bazike**

MKLARG Kërcimi nga vendi në largësi

MKLART Kërcimi nga vendi në lartësi

VR30m Vrapim i shpejtë 30 m

HETBL Hedhja e topit të basketbollit në largësi

#### **Ndryshoret situacionale**

MGJTGJD Gjuajtja e topit në kosh nga gjysmë-distanca

MGJULIR Gjuajtjet e lira

MDRVA20m Vajtje-ardhje me driblim 20m

## 4.2.2.Përshkrimi i ndryshoreve morfologjike

### 1. Lartësia e trupit

Për të matur lartësinë trupore është përdorur antropometri sipas Martinit. Nxënësi gjatë matjes është i pajisur me shorce fanelë dhe qorape sportive, i vendosur në sipërfaqe të rafshtë dhe të fortë. Subjekti qëndron në pozitë të drejtqëndrimit, me muskulaturë të relaksuar të trupit. Pozita e kokës qëndron në atë pozitë, ku nofulla merrë pozitën horizontale të ashtuquajtur "Horizontalja e Frankfurtit" ndërkaq shputat të bashkuara nga pjesa e prapme. Matësi qëndron nga ana e majtë dhe vendos prapa trupit të subjektit antropometrin, ku me dorën e djathtë lëshon unazën metalike me shtyllën horizontale derisa ajo takon pjesën e sipërme të kokës.Në unazën rrëshqitëse shikohet rezultati i cili shënohet në fletën testuese të subjektit me saktësi të matjes prej 0.1 cm.



Foto 1

## 2. Pesha e trupit

Pesha e trupit matët me peshojë decimale lëvizëse, e cila mundëson saktësinë e matjës prej 0.1 kg. Peshoja është domosdoshme të vëhët në pozitë horizontale, dhe për çdo ditë para përdorimit dhe pas 10 matjeve të bazhdarohet. i maturi është i zbathur, në brekë të shkurtër, qëndron në këmbë i qetë në mes të peshojës. Pasi që treguesi të qetësohet, rezultati lexohet me saktës 0.1 kg.



Foto 2

### 3. Gjatësia e krahut

Gjatësia e krahut matet me antropometër sipas Maritinit. Nxënësi qëndron në pozitë të drejtqëndrimit, me krah anash trupit dhe të relaksuar. Pjesa e epërme e antropometrit vendoset në pjesën më të gjerë të krahut. Rezultati në fletëtestim shënohet me saktësi prej 0.1cm.



Foto 3



#### 4. Gjatesia e këmbës

Gjajtësia e këmbës është matur me antropometër. i testuari duhet të qëndrojë sikurse në matjen e lartësisë trupore. Matja bëhet nga dyshemeja ku qëndron i eksperimentuari deri në pikën e quajtur “gjembi i sipërm i përparmë i çapokut” (spina iliaca anterior superior) të anës së majtë, e cila caktohet me gishtin e mesëm të dorës që mban pjesën horizontale të antropometrit. Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.



Foto 4



### 4.2.3.Përshkrimi i ndryshoreve të motorikes bazike

#### 1. Kërcimi nga vendi në largësi

Testi i kërcimi nga vendi në largësi është realizuar duke bërë shtytje nga vendi me të dy këmbët. U lejohen lëvizjet e hovit me duar, ndërsa këmbët vendosën mbrapa vijës së kërcimit. Kërcimi bëhet me forcë maksimale, duke kërcyer me këmbë të bashkuara. Kërcimi bëhet mbi dyshek, sa më gjatë që të jetë e mundur. Gjatësia e kërcimit matet me centimetra, pra distancë në mes të vijës së nisjes dhe shenjës më të afërt të thembrës në dyshek. Prej tri tentimesh, shënohet rezultati më i favorshëm, madje prej 0.1 cm.




Foto 5

## 2. Kërcimi nga vendi në lartësi

Testi i kërcimi nga vendi në lartësi është realizuar kur nxënësi është i kthyer brinjazi prej shiritit centimetrik, së pari e ngritë krahun i shtrirë lart në të gjitha nyjet. Matet lartësia nga dyshemeja deri të gishtit të mesëm, që shënohet me centimetra. I testuari nga qëndrimi vertikal i kthyer nga shiriti centimetrik i improvizuar, që është i lejuar lëvizja e krahut, kërcen dhe e prek shiritin me njëren dorë, varësisht nga është kthyer, në anën e majtë apo të djathtë. Pas matjes së lartësisë pa kërcim në shtrirjen e krahut dhe pas kërcimit nga vendi, e gjejmë lartësinë e shkëputjes nga vendi. Prej tre tentimesh shënohet rezultati më i favorshëm, madje prej 0.1 cm.



Foto 6

### 3. Vrapim i shpejtë 30 m

Testi i vrapimit të shpejtë 30 metra është realizuar në shtegun e gjatë prej 30 metrash nga vija e nisjes deri te vija e caktit në sallën e edukimit fizik dhe sportit të shkollës. Gjerësia e shtegut është 1.20m. I testuari nga pozita e nisjes së poshtë, pas komandës “gati” dhe sinjalit për nisje vrapon me shpejtësi maksimale distancën prej 30m. Koha matet nga momenti i sinjalit për nisje e derisa vrapuesi të kalojë me gjoks rrafshin vertikal mbi vijën e caktit. Rezultati shënohet me saktësi prej 0.1 sec.



Foto 7

#### 4. Hedhja e topit të basketbollit në largësi

Testi i hedhjes së topit të basketbollit në largësi është realizuar në këtë mënyrë, nxënësi duhet të jetë në këmbë me dy këmbët paralel, duart duhet të jenë të shtrira afër trupit dhe aty ku prekin gishtat e gjatë të duarve, aty shënohet vija nga fillon matja. I testuari në atë pozitë merr topin e basketbollit me të dy duart, që janë të shtrira në lartësi të gjoksit dhe me tërë forcën e gjuan topin në gjatësi pa pasur të drejtë ta ndryshoj pozitën e trupit. I testuari gjuan 3 (tre) herë, ndërsa shënohet rezultati më i mirë madje prej 0.1 cm.



Foto 8



#### 4.2.4.Përshkrimi i ndryshoreve të motorikes situacionale

##### 1. Gjuajtja e topit në kosh nga gjysmë-distanca

Testi i gjuajtjes së topit në kosh nga gjysëm distance është realizuar, kur nxënësit i është caktuar pozita prej nga do të bëhet gjuajtja dhe e njejta është bërë në sallën e edukimit fizik dhe sportit. Gjuajtjet nga gjysëm distanca në kosh bëhet në këtë mënyrë , nxënësin e vendosim në hapësirën nga distanca për gjuajtje, numri i gjuajtjeve bëhet nga 5 (pesë) herë dhe praktika e gjuajtjeve bëhet në vende të ndryshme rreth hapësires për gjuajtje, për shënimet e sakta mirret rezultati më i mirë.



Foto 9

## 2. Gjuajtjet e lira

Testi i gjuatjes së lire është realizuar atëherë, kur nxënësi është vendosur tek pozita prej nga do të bëhet gjuajtja dhe e njehta është bërë në sallën e edukimit fizik dhe sportit. Nxënësi vendoset në hapësirën për gjuajtje të lira dhe ka ekzekutuar gjuajtjen me doren në të cilën e preferon nxënësi në mënyrë që të testohet saktësia e gjuatjes së lirë të topit në kosh kjo gjuatje përsëritet 5 (pesë) herë dhe mirret rezultati i shënimeve të koshit.



Foto 10

### 3. Vajtje-ardhje me driblim 20m

Testi i vajtje-ardhje me driblim 20 metra është realizuar në sallën e edukimit fizik dhe sportit në shkollë. Për të realizuar testin e driblimit me top vajtje-ardhje nxënësi ka udhëhequr me topi në fushë bëhet në gjatësi të fushës së basketbollit. Udhëheqja bëhet në drejtim drejtvizorë të fushës së basketbollit. Nxënësi fillon me shenjën “tash” duke e udhëhequr topin drejt, duke dribluar ne top vajtje dhe ardhje. Matet koha e nisjes me kronometër deri te kalimi i lojtarit dhe topit në cak vajtje ardhje. Testi përsëritet 5 (pesë) herë dhe merret rezultati më i mire.




Foto 11

#### **4. MËNYRA E ZBATIMIT TË PUNIMIT**

Për realizimin të detyrave të parashtruara në këtë hulumtim master, ne kemi aplikuar metodën deskriptive statistikore, si dhe metodat shkencore të parashikimit të rezultateve.

Rezultatet janë përpunuar me anë të programit kompjuterik SPSS versioni 20.0.

Niveli deskriptiv i analizës së variablave të përfshira në hulumtim është kryer me ndihmën e këtyre metodave :

Parametrat themelor statistikor:

- Mesatarja aritmetikore
- Ds - Devijimi standard
- Min – Rezultati minimal
- Max – Rezultati maksimal
- Masat e asimetrisë Skeënes dhe Kurtosis
- Korelacioni
- Kroskorelacioni në mes të ndryshoreve antropometrike dhe motorike
- Analiza faktoriale për të gjithë nxënësit.



## **6.REZULTATET DHE DISKUTIMET**

### **6.1. Treguesit themelor statistikorë në hapësirën antropometrike dhe motorike në matjet e nxënësve të moshës 13 vjeçare.**

Në këtë punim kemi aplikuar katër ndryshore antropometrike dhe tetë ndryshore të motorikës bazike dhe motorikës specifike për basketboll, një numër i ndryshoreve për të cilat mendohet janë të mjaftueshme për të zhvilluar një hulumtim të tillë për master. Siç shihet në tabelën nr. 1. janë dhënë rezultatet e analizës themelore statistike ku mostër e këtij hulumtimi kanë qenë 30 nxënës të moshës 13- vjeçare.

Në këtë tabelë janë paraqitur treguesit themelorë statistikorë në hapësirën antropometrike në matjet e nxënësve të moshës 13 vjeçare rezultatet: Numri i nxënësve (N); rezultati minimal (min); maksimal (max.); mesatarja aritmetikore (mean); devijimi standard (std. dev) dhe masat e asimetrisë (skeë dhe kurt). Ndërsa në tabelë janë treguar rezultatet e hapësirës antropometrike, motorikës bazike dhe motorikës specifike, duke u bazuar në rezultatet e paraqitura në tabelën nr. 1. ndërmjet rezultatit minimal dhe maksimal të reflektuara nga devijimi standard, vlerat e ndryshoreve antropometrike tregojnë për një shtrirje jo edhe aq simetrike sepse rezultatet e devijimit standard tregojnë për një devijim më të lartë në ndryshoret e lartësisë së trupit në vlerë prej (9.278), peshës së trupit në vlerë prej (12.688), dhe gjatësisë së krahut në vlerë prej (9.612), rezultatet të cilat për këtë moshë mund të jenë konform rritjes dhe zhvillimit të nxënësve sepse është mosha e fillimit të pubertetit dhe disa rritjen dhe zhvillimin e kanë më të hershëm e disa më të vonë. Gjithashtu edhe tek hapësira motorike mund të vërejmë se kemi rezultatet të cilat tregojnë për devijim më të lartë nga rezultatet minimale dhe ato maksimale siç është ndryshorja e kërcimit së largu në vlerë prej (23.839), ndërsa rezultatet tjera tregojnë vlera në suaza të normales, e këtë e vërtetojnë edhe rezultatet e masave të asimetrisë të cilat tregojnë një shpërndarje të mirë të rezultateve të arritura apo vlera të një grupi mjaft homogjen.

**Tabela 1. Treguesit themelorë statistikorë në hapësirën antropometrike në matjet e nxënësve të moshës 13 vjeçare**

Ndryshoret	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Dev	Skeë	Kurt
Alartrup	30	146.5	180.3	163.3633	9.2781	-0.067	-0.842
Apeshtrup	30	35.9	85.8	54.0333	12.68883	0.514	-0.256
Agjatkrahu	30	64.5	106.8	77.1967	9.61215	1.617	2.678
Agjatkemb	30	91.2	110.6	99.3832	4.7759	0.453	0.281
Mkerlarge	30	110.8	206.5	159.6967	23.83966	-0.237	-0.651
Mkerlarte	30	21	44.6	32.7367	5.76179	0.103	-0.21
Mvr30m	30	4.73	6.52	5.6217	0.4274	0.391	0.171
Mhedhtop	30	7	13.81	9.811	1.81364	0.436	-0.478
Mgjuaj5poz	30	1	5	2.8	1.21485	0.04	-1.016
Mgjuajtjelire	30	0	5	2.3	1.48904	0.585	-0.6
Mvajtjeardh	30	8.34	12.45	10.151	1.00904	0.313	-0.206

## 6.2. KORELACIONET E NDRYSHOREVE MOTORIKE MANIFESTE TË NXËNËSVE TË MOSHËS 13 -vjeçare

### 6.2.1 Korelacionet e ndryshoreve në hapësirën antropometrike manifeste të nxënësve

Në tabelën 2 janë paraqitur rezultatet e korelacioneve në hapësirën antropometrike të nxënësve të cilët ndjekin me rregull procesin mësimor në orët e edukimit fizik dhe sportit.

Në bazë të rezultateve të cilat vërehen në tabelën nr. 2 në të cilën paraqiten rezultatet e korelacioneve në hapësirën antropometrike të nxënësve mund të vërehet disa nga rezultatet e larta të korrelacionit siç janë ndryshorja e lartësisë së trupit me peshën e trupit në vlerë prej (0.646\*\*), me ndryshoren e gjatësisë së këmbës në vlerë prej (0.594\*\*), ndërsa nuk ka treguar korrelacion të vlefshëm me gjatësinë e krahut, ndryshorja e peshës së trupit përveq korrelacionit me lartësinë e trupit ka treguar vlerë të lartë të korrelacionit edhe me gjatësinë e këmbës në vlerë prej (0.483\*\*), gjatësia e krahut ka treguar vlerë të lartë korrelative vetëm me gjatësinë e këmbës në vlerë prej (.487) ndërsa gjatësia e këmbës ka treguar vlera të larta korrelative më të gjitha ndryshoret në vlerë prej (0.483\*\* deri 0.594\*\*)

**Tabela 2 Korelacionet në hapësirën antropometrike të nxënësve**

Ndryshoret	Alartrup	Apeshtrup	Agjatkrahu	Agjatkemb
Alartrup	1			
Apeshtrup	.646**	1		
Agjatkrahu	0.282	0.321	1	
Agjatkemb	.594**	.483**	.487**	1

## 6.2.2. Korelacionet e ndryshoreve në hapësirën e motorikës bazike dhe motorikës specifike manifeste të nxënësve

Në tabelën 3 janë paraqitur rezultatet e korelacioneve në hapësirën e motorikës bazike dhe motorikës specifike të nxënësve të cilët ndjekin me rregull procesin mësimorë në orët e edukimit fizik dhe sportit, Duke e analizuar tabelën nr. 3 ku paraqiten të dhënat e korelacioneve për ndryshoret motorike janë fituar rezultate disa vlera mjaft të larta dhe të vlefshme e sidomos vlera më të larta kanë dhënë treguesit e dimensioneve të forcës eksplozive ndërmjet veti dhe me disa nga ndryshoret e lëvizjeve specifike.

Ndryshoret nga hapësira motorike të cilat kanë treguar koeficient të lartë korelativ janë testi forcës eksplozive i kërcimit së largu me testin e vrapimit 30m, në vlerë prej (-0.446\*\*), testin e gjuajtjes së lire në vlerë prej (0.489\*\*), testin e vajtje ardhjes në vlerë prej (-0.496\*\*) dhe me testin e kërcimit se larti në vlerë më të ulët prej (0.373\*). Testi i kërcimit së lartë me testin e vrapimit 30m në vlerë prej (-0.816) me testin e gjuajtjes së lirë në vlerë prej (0.397\*), testin vajtje -ardhje në vlerë prej (-0.416\*\*) dhe testi tjetër i forcës eksplozive vrapim 30 metra ka treguar korrelacion të lartë me testin e vajtje-ardhje në vlerë prej (0.489\*\*). Ndërsa testet e motorikës specifike kanë treguar vlera të larta korrelative ndërmjet veti sic është rasti i gjuajtjes se 5 (pesë) pozicioneve me testin e gjuajtjes së lirë në vlerë prej (0.606\*\*).

**Tabela 3 Korelacionet në hapësirën motorike të nxënësve**

Ndryshoret	Mkerlarge	Mkerlarte	Mvr30m	Mhedhtop	Mgjuaj5poz	Mgjuajtjelire	Mvajtjeardh
Mkerlarge	1						
Mkerlarte	.373*	1					
Mvr30m	-.446*	-.816**	1				
Mhedhtop	0.307	0.282	-0.335	1			
Mgjuaj5poz	0.213	0.360	-0.338	0.192	1		
Mgjuajtjelire	.486**	.397*	-0.216	0.152	.606**	1	
Mvajtjeardh	-.496**	-.416*	.489**	-0.264	-0.196	-0.246	1

### 6.3. KROSKORELACIONET E NDRYSHOREVE MANIFESTE

#### 6.3.1 Kroskorelacionet ndërmjet ndryshoreve në hapësirën antropometrike manifeste të të nxënësve

Në tabelën 4 janë paraqitur rezultatet e kroskorelacioneve ndërmjet ndryshoreve në hapësirën antropometrike të nxënësve të cilët ndjekin me rregull procesin mësimor në orët e edukimit fizik dhe sportit.

Gjatë një analize të bërë në amëzën e korelacioneve mund të vërehet se disa nga ndryshoret në hapësirën antropometrike janë fituar rezultate të nivelit të ulët të kroskorelacionit ndërsa prej tyre kanë treguar vlera të vlefshme korelative e por jo të rëndësishme të lartë statistikore.

**Tabela 4 Kroskorelacionet në hapësirën motorike të nxënësve**

Ndryshoret	Alartrup	Apeshtrup	Agjatkrahu	Agjatkemb
Mkerlarge	0.153	-0.086	-0.078	0.202
Mkerlarte	0.043	-0.243	-0.016	-0.016
Mvr30m	-0.178	0.090	-0.188	-0.054
Mhedhtop	0.276	0.284	0.054	0.238
Mgjuaj5poz	-0.034	-0.140	0.166	-0.133
Mgjuajtjelire	0.030	-0.114	0.150	0.116
Mvajtjeardh	-0.257	0.048	0.051	-0.136

## 6.4. FAKTORIZIMI I HAPËSIRËS MANIFESTE

### 6.4.1 Faktorizimi i hapësirës antropometrike të nxënësve 13 vjeçarë

Në tabelën nr. 5 janë paraqitur rrënjët karakteristike nga amëza e ndërlidhjeve, të cilat shpjegojnë tërë sistemin e ndryshoreve antropometrike të nxënësve. Më këtë rast është ekstrahuar vetëm një faktor me rrënjë të vlefshme karakteristike e cila shpjegon me 60.674% të variancës së përbashkët të sistemit, e cila mundëson izolimin e vetëm një komponente kryesore.

Në tabelën nr.6. është dhënë komponenta kryesore e amzës së interkorelacioneve (faktori 1) dhe komunalitetet e ndryshoreve ( $h^2$ ) ku në bazë të amzës dallohen vlerat e fituara të analizës faktoriale.

Në tabelën nr:6 në komponenten e vetme kryesore (faktori 1) na jep vlera të larta të ndryshoreve, ALATRUP, APESHTRUP , AGJATKRAHU dhe AGJATKEMB me vlera prej 0.629 DERI ME 0.834 me këto vlera mund të definojmë faktorin: **Faktori longitudinal dhe transversal së trupit.**

Gjithashtu edhe vlerat e komunaliteteve kanë treguar vlera të larta të cilat variojnë prej: .656 deri në .857, përveq APESHa e cila nuk ka treguar vlerë të lartë të komunalitetit.

**Tabela 5. Rrënjët karakteristike dhe pjesët e shpjeguara të variancës së përbashkët të amzës së interkorelacioneve të ndryshoreve antropometrike të nxënësve**

Total Variance Explained						
	Total	% of Variance	Cumulative %	Total	% of Variance	Cumulative %
1	2.427	60.674	60.674	2.427	60.674	60.674
2	0.805	20.121	80.796			
3	0.467	11.672	92.467			
4	0.301	7.533	100.000			

**Tabela 6. Komponentet kryesore të amezës së korelacioneve dhe të komunalitetit (h<sup>2</sup>) të ndryshoreve antropometrike të nxënësve në faktorë të izoluar.**

Ndryshoret	Faktori 1	Komunalitetet h <sup>2</sup>
Alartrup	0.834	0.695
Apeshtrup	0.801	0.642
Agjatkrahu	0.629	0.396
Agjatkemb	0.833	0.694

### **Faktorizimi në hapësirën motorike të nxënësve**

#### **6.4.2 Faktorizimi i hapësirës motorike të nxënësve 13 vjeçarë**

Në tabelën nr. 7 është paraqitur amëza e barazimeve karakteristike që shpejtojnë sistemin e ndryshoreve manifeste motorike të nxënësve të cilët ndjekin me rregull procesin mësimorë në orët e edukimit fizik dhe sportit, me ç'rast janë ekstrahuar dy faktorë me pjesë të veçanta të variancës të shprehura dhe me kontribut komulativ të rrënjëve karakteristike.

